



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË MATURANTËVE NË KUADËR TË PRANIMIT NË PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË

Për të gjithë maturantët aplikantë për pjesëmarrje në testimin e informatizuar në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online gjatë periudhës **06 – 10 Gusht 2026** nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

Faturën për arkëtim për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, në linkun:

https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/Fatura_provime.pdf

Maturantët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit qeveritar e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia dhe me anë të kodit unik të gjurmimit do të mund të gjurmojnë në çdo kohë statusin e aplikimit.

Testimi i informatizuar do të zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH).

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, maturantët duhet të kenë parasysh:

- të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- firmos deklaratën e rezultatit të marrë.

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo maturant, do të publikohet në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore <http://www.qsha.gov.al/>

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Kandidati ka të drejtë të ankimojë rezultatin, duke paraqitur ankesën me shkrim, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore brenda 1 (një) dite nga shpallja e rezultatit të testimit të informatizuar.

Ju urojmë Suksese!